



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në
Ujësjetës Kanalizime FIER SH. A.**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT”**

Tiranë, më 25.06.2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetellës Kanalizime FIER SH. A.

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	Përmbledhje Ekzekutive	3
	a Përshkrimi i shkurtër i Auditimit	3
	b Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi	3
	c Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	5
II.	Hyrja	5
	a Objektivat dhe qëllimi	6
	b Identifikimi i çështjes	6
	c Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
	d Përgjegjësitë e audituesve	7
	e Kriteret e vlerësimit	7
	f Standardet e auditimit	8
III	Përshkrimi i Auditimit	8
IV	Gjetjet dhe Rekomandimet	9
1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	
	<i>a. Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në Tik.</i>	
	<i>b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit</i>	9-12
2	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	
	<i>a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime</i>	
	<i>b. Procedurat e investimeve në fushën TIK</i>	
	<i>c. Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement)</i>	13-17
3	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	
	<i>a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i>	
	<i>b. Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i>	17-22
4	Auditimi i sistemeve	
	<i>a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output</i>	
	<i>b. Politikat mbi testimin e sistemeve IT dhe menaxhimi i konfigurimeve</i>	22-26
5	Të ndryshme	26-29
V	Konkluzionet dhe Opinioni i Auditimit	29-36



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

a. Përshkrimi i shkurtër i Auditimit

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në UKF Sh.A., është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së për vitin 2020 të Miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me vendim nr. 145 datë 28.01.2020. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që shoqëria disponon, për të garantuar vazhdimësi dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimarrjen.

Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmëria. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

- Teknologjia e Informacionit në UKF Sh.A është zhvilluar në mungesë të një plani strategjik i cili të mbështesë arritjen e objektivave të vetë institucionit.
- Nuk disponon një regjistër risku për identifikimin, kategorizimin, ndjekjen dhe minimizimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit.
- Nuk disponon një plan vazhdimësie për ofrimin dhe garantimin e shërbimit në rast ndërprerje nga shkaqe natyrore apo njerëzore.
- Nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve , aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF.
- Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “Al Billing” rezulton se kur faturat hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkriminale (Automatike rritës sipas radhës), si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s’ të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A.	FQ.11	E LARTË	Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit
2.	Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.	FQ.13	E LARTË	Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A në bashkëpunim me specialistin e IT të marrin masa e hartimit, miratimit dhe zbatimit të rregullave për: identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve
3.	Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.	FQ 19	E LARTË	Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A në bashkëpunim me Specialistin e IT të marrin masa për miratimin e një plani për emergjence dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit
4.	Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve , aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF	FQ.19	E LARTË	UKF Sh.A për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marrin masat për t’u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet dhe me praktikën ,më të mira. Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.
5.	Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “AI Billing” për			Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	periudhën 01 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezultoi se janë kryer veprime duke krijuar 94.970.256 "Hendeqe" në fushën ID.(bashkëlidhur këtij akt konstatimi rekordet me hendeqe në fushën ID). Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkriminale (Automatike rritës sipas radhës), si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s'të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.	FQ 26	E LARTË	Sh.A të marrin masa për hartimin e rregullave dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës në kryerjen e sistemeve dhe mos krijimin e hendeqe në ID.

c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Grupi i auditimit KLSH duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit në përmbushjen e misionit të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A., duke mbështetur auditimin në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 1 Neni 22, Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14, Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA), COBIT 4.1, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23, ISSAI 100.36,48, ISSAI 5310), pas shqyrtimit të të dhënave dhe dokumentacionit TI të vënë në dispozicion nga Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A., arriti në konkluzionin se:

Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A. ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatore për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore.

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikën më të mirë si dhe rekomandimet e AKSHIT.

Të dhënat e ruajtura në sistemet nuk janë të sigurta.

Gjenerimi i faturave nga UKF Sh.A është në kundërshtim me Ligjet Tatimore.

Sistemet TI janë të kompromentuar nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKF Sh. A. për mbështetje e veprimtarisë së saj.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit Nr. 67/1, datë 11.02.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 21.01.2020 deri në 15.04.2020, në UKF Sh.A., për periudhën nga 01.01.2019 deri në 31.12.2019, u krye "Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit", me Grup Auditimi të përbërë nga:

1. M.H, Përgjegjëse Grupi
2. R.A, Anëtar
3. E.K, Anëtar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista, për caktimin e zonave me risk të lartë mbështetur në to vlerësoi matricat dhe hartoi programin e auditimit bazuar në manualin Aktiv të Auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

a. Objektivat dhe qëllimi:

Objekti i Auditimit TIK ushtruar në UKF Sh.A., është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në UKF Sh.A., është vlerësimi nëse se ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin / mirëmbajtjen / zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Objektivat e këtij auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, vizionin, qëllimin dhe objektivat e UKF Sh.A., duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullativ në bazë të të cilit institucioni zhvillon veprimtarinë e tij. Për të arritur në dhënien e një opinioni, është mbledhur informacion, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, ndihmon realizimin e synimeve të subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente.

b. Identifikimi i çështjeve:

Pas marrjes së informacionit nga subjekti dhe përpunimit të tij nga grupi i auditimit kanë rezultuar si fusha me risk më të lartë si më poshtë:

1. Auditimi i funksioneve të Qeversisjes TIK

- a. Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në Tik.
- b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit

2. Auditimi i zhvillimi dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

- a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime
- b. Procedurat e investimeve në fushën TIK
- c. Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement)

3. Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit
- b. Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre

4. Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit

- a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output
- b. Politikat mbi testimin e sistemeve IT dhe menaxhimi i konfigurimeve

5. Të ndryshme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

- UKF Sh.A është përgjegjës për ofrimin e shërbim të qëndrueshëm ujësjellësi në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur, në përputhje me standardet në fuqi dhe me çmim të arsyeshëm, për të gjithë konsumatorët.
- UKF Sh.A është përgjegjës për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura me qëllim që të ruajë shëndetin publik dhe në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.
- UKF Sh.A është përgjegjës për të administruar shoqërinë në formën e një biznesi me qëllim që ajo të jetë financiarisht e qëndrueshme.
- UKF Sh.A është përgjegjës për të investuar në rritjen e kapaciteteve të punonjësve të shoqërisë dhe në sigurimin për ta të kompensimit të drejtë për të nxitur interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët e shoqërisë.

d. Përgjegjësitë e audituesve:

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi UKF Sh.A., mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2019, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK. Nga Grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit Nr. 67/1, datë 11.02.2020, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në realizimin e këtij Auditimi, Grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon UKF Sh.A. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

e. Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit bazohen në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet e përcaktuara nga AKSHI si dhe ato ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit. Opinionet dhe konkluzionet e nxjerra nga auditimi janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, janë dokumentuar në aktet e mbajtura, observacionet gjenden të reflektuara në këtë Raport, gjithashtu rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Auditimi në UKF Sh.A. i është referuar bazës ligjore si më poshtë:

1. Ligji nr. 119/2014 “Për Të Drejtën e Informimit”
2. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”
3. Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”
4. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar
5. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
6. ISSAI 5310, Manuali i Auditimit IT, COBIT 4.1
7. VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 “për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

8. Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve.
9. Ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
10. Ligj 8237 01.09.1997. Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare
11. Vendim i KM 660 12.09.2007.
12. VKM 1304 dt.11.12.2009.
13. VKM nr.236 datë 10.05.1993 Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë i ndryshuar

f. Standardet e auditimit:

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: ISSAI 5310, Manuali i Auditimit IT, COBIT 4.1, etj

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. UKF Sh.a. administron një rrjet ujësjellësi prej 436 km nga i cili 194 km rrjet kryesor dhe 242 km rrjet shpërndarës. UKF Sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për rreth 133,4 mijë banorë dhe ka të regjistruar 37,299 klientë nga të cilët 21,006 janë të paisur me matës konsumi. Gjithashtu realizon largimin e ujrave të ndotura nëpërmjet një sistemi me rredhje të lirë dhe një rrjeti kanalizimesh prej 99 km. Shërbimi i kanalizimeve i ofrohet rreth 75,6 mijë banorëve duke regjistruar për këtë shërbim 26,929 klientë nga të cilët 23,965 janë në qytet dhe vetëm 2,955 janë në fshat. Megjithatë rezulton që i gjithë territori i bashkisë ka mbulim jo shumë të mirë me shërbimin e ujësjellës – kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm Ujësjellës-Kanalizime Fier Sh.a, furnizohet me ujë nga ujëmbledhësi Kafaraj, i cili shfrytëzon nëntë puse, ndër të cilët tre janë të reja dhe gjashtë të vjetra. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet nga ujëmbledhësi Kafaraj është 700l/sek.

2. Objekti i Auditimit TIK ushtruar në UKF Sh.A., është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në UKF Sh.A., është vlerësimi nëse se ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin / mirëmbajtjen / zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Objektivat e këtij auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, vizionin, qëllimin dhe objektivat e UKF Sh.A., duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullativ në bazë të të cilit institucioni zhvillon veprimtarinë e tij. Për të arritur në dhënien e një opinioni, është mbledhur informacion, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, ndihmon realizimin e synimeve të subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetellës Kanalizime FIER SH. A.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

1.a, Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

1.a Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në Tik.

Objektivi i Auditimit:

Garantimi se ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat në strukturat IT që mundësojnë Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A të arrijë objektivat në funksion të plotësimit të misionit. Konfirmimi nëse ekziston një strategji IT, e cila përfshin planin e IT dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, dhe zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A. Risqet dhe burimet gjatë përmbushjes së objektivave të IT janë të menaxhuara efektivisht.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të Fushës së Myzeqesë. **Bashkia Fier** ka një sipërfaqe prej 620 km² dhe popullsi prej 122,475 banorësh. Përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. UKF Sh.a. shfrytëzon burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Nëpërmjet këtyre burimeve, shoqëria prodhon mesatarisht 10,7 milion m³ ujë në vit nëpërmjet 37 sistemeve me ngritje mekanike. Volumi i ujit të prodhuar pjesërisht matet dhe pjesërisht vlerësohet.



Vizioni

UK Fier të jetë ofruesi më i mirë i dhe më cilësor i shërbimit ujësjetellës në raport me Shoqëritë e tjera të Ujësjetellës Kanalizimeve në Shqipëri.

Objektivat

- Zbatimin e strategjive të përshtatshme të menaxhimit të kërkesës për ujë me qëllim reduktimin e ujit të pafaturuar (diferencën ndërmjet prodhimit e shitjeve).
- Optimizmin e përdorimit të pompave me qëllim reduktimin e numrit të pompave në shërbim, rritjen e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të tyre dhe përmirësimin në përgjithësi të vazhdueshmërisë së furnizimit me ujë.
- Faturimin e saktë të të gjithë klientëve që marrin shërbime nga shoqëria , nëpërmjet mbulimit në rritje me matës konsumi dhe kështu , arritjen e faturimit mbi baza volumetrike.
- Rritjen e normës së arkëtimit (llogaritur me 90%).
- Evidentimin e zonave gri atje ku shoqëria nuk ofron shërbim dhe qytetarët faturohen për shërbimin e munguar për të ulur borxhin e keq dhe shpenzimet gjyqësore.
- Uljen e shpenzimeve operative në mirëmbajtjen e mjeteve dhe përdorimin sa më eficient të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1304, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.”

Drejtori i përgjithshëm, në rolin e Administratorit, emërohet nga Kryetari i Bashkisë Fier, i cili ka autoritetin të drejtpërdrejtë tek Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Legjislacionit dhe Prokurimeve, Departamenti Tregtar (Drejtoria Tregtare), Departamenti Teknik (Drejtoria Teknike) dhe Sektorin e Taks-Forcës.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A është gjithsej 360 punonjës .

Specialisti i IT është pjesë përbërëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Struktura aktuale përbëhet nga 1 punonjës (*Specialist IT*).

Nga auditimi rezultoi se:

1. **Titulli i gjetjes:** Teknologjia e informacionit zhvillohet pa Plan Strategjik.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Ndikimi/efekti: Keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

2. **Titulli i gjetjes** Nuk janë krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të rregulloreve dhe politikave të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

Situata: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka politika mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A dhe nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

Ndikimi/efekti: Mos realizim të objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Standardet e Praktikave me të mira rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund ti referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikat duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT. Mos përdorimi i mjeteve të komunikimit si intranet etj.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A., të marrin masa për hartimin e dokumenteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje në institucion si dhe njohjen me rregulloret dhe politikat TIK ekzistuese të të gjithë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime FIER SH. A.

punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

3. Titulli i gjetjes: Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka hartuar bazën rregullative të Teknologjisë së Informacionit (*rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike*).

Situata: Struktura IT nuk ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj).

Ndikimi/efekti: Baza nënligjore e pa hartuar mbart riskun e mos realizimit të objektivave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e backup etj).

4. Titulli i gjetjes: Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

Situata: Nga auditimi rezultoi se UKF për vitin 2019 nuk ka kryer trajnime dhe nuk ka një analizë të nevojave për trajnim të stafit IT si dhe plan trajnimi.

Ndikimi/efekti: Mos realizimin e objektivave institucionale në fushën e IT.

Shkaku: Mos kryerja e analizës së nevojave për trajnim, mos hartimit dhe zbatimit të planit të trajnimeve nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe struktura IT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

5. Titulli i gjetjes: Struktura IT në Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A është në nivel specialisti nën Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Situata: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

Ndikimi/efekti: Zbehje të ndikimit të IT në vendimmarrje.

Shkaku: Probleme konceptuale organizative mbi rendësin e IT

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetellës Kanalizime FIER SH. A.

1.b. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.

1.b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve me impakt në ofrimin e shërbimit.

Objektivi i auditimit: Verifikimi se të gjithë risqet e lidhur me sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe se ekziston një strategji e përshtatshme për reduktimin e riskut.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A.

Gjetje nga Auditimi :

1. Titulli i gjetjes Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2. Titulli i gjetjes Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

3. Titulli i gjetjes Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme.

Situata: Mos menaxhim i incidenteve, mos vlerësim i risqeve IT, mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa e hartimit, miratimit dhe zbatimit të rregullave për:

- a) identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- b) dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- c) menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
- d) miratimin e regjistrit të riskut.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetellës Kanalizime FIER SH. A.

2.a/b Auditimi i zhvillimi dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

2.a. “Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime”

2.b. “Procedurat e investimeve në fushën TIK

Objektivat e auditimit:

- Vlerësime nëse agjencia ka zhvilluar një procedurë prokurimi në përputhje me rregullat, udhëzimet dhe ligjet në fuqi.
- Vlerësime nëse është përmbushur objektivi i agjencisë dhe arritur produktiviteti i duhur nga procedurat e prokurimit.

Për gjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2019, periudhë mbi të cilën Ujësjetellës-Kanalizime Fier Sh.A. (UKF) është nën auditim, ka kryer identifikimin, planifikimin dhe pajisjen me mallra dhe shërbime në fushën e IT, nga drejtoritë përkatëse.

Si rezultat i mos pasjes së një strukture IT në nivel sektori, e bën të pamundur përfshirjen në planifikimin e këtij Plani Ekonomik.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur Prokurimet që mbulojnë fushën e IT për vitin 2019.

Lista e objekteve të prokuruarra për IT

Nr	Objekti i procedurës Emertimi	Lloji i prokurimit	Fondi limit (Pa tvsh) Në lek	Operatori fitues	Nr.prot. Data e kontratës	Vlera e ofertave të paraqitura nga fituesi (Pa tvsh) Në lek	Diferenca nga fondi limit (Pa tvsh)	Vlera e kontratës (me tvsh)
a	1		3	4	5	6	7	8
1	Shërbim mirëmbajtje AL-Billing	Me negocim, pa njoftim	770.000	xxxx Sh.p.k	23.05.2018	760.000	10.000	912.000
2	Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF	Kërkesë për propozim	1.999.308	xxxx	25.07.2019	1.174.080	825.920	1.408.824
3	Shërbime Printerash, Fotokopje dhe Kompjuterash	Blerje me vlerë të vogël	390.000	xxxx	19.03.2019	390.000	10.000	468.000
4	Shërbim Printim Faturash	Kërkesë për propozim	3.000.000	xxxx	16.04.2019	2.644.800	355.200	3.173.760
5	Blerje bojra për printera	Blerje me vlerë të vogël	295.000	xxxx	01.02.2019	59.000	236.000	70.800
	Total		6.454.308			5.027.880	1.437.120	6.033.384

Procedurat e Prokurimit Publik

Ujësjetellës-Kanalizime Fier Sh.a. për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 ka aktive të lidhura 5 kontrata :

- Kontrata më datë 23.05.2018 me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

- b) Kontrata më datë 25.07.2019, me objekt “*Sherbim Interneti LAN TO LAN per Nevojat e Sh.a UKF*” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k.
- c) Kontratë më datë 16.04.2019, me objekt “*Shërbim Printim Faturash*” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k.
- d) Kontrata më datë 19.03.2019, me objekt “*Shërbime Printerash, Fotokopje dhe Kompjuterash*” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k.
- e) Kontrata më datë 01.02.2019 me objekt “*Blerje bojra për printera*” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx”

Gjetjet nga Auditimi:

1. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. ka kryer procesin e identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit por kjo në mungesë të strukturës të IT.

Situata: Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Strukturat e IT-së nuk janë përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave si dhe nuk përfshihen në procesin e menaxhimit të tyre.

Ndikimi/Efekti: Mosfunksionimi i strukturës së IT-së sjell pasoja negative në mbarëvajtjen e e procesit të identifikimi dhe menaxhimit të nevojave për investime ne fushën e teknologjisë dhe informacionit.

Shkak: Mungesa e një plani strategjik të mirëfilltë për krijimin e një strukture IT.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. rishikojë pozicionimin e strukturës IT afër qeverisjes me qëllim kryerjen e analizimin, prioritarizimin dhe planifikimin e nevojave për sistemet e reja dhe ekzistuese të Teknologjisë së Informacionit në të ardhmen si dhe të marri masa për rritjen e bashkëveprimit ndërinstytucional në përputhje me politikat dhe strategjitë për parashikimin dhe koordinimit e investimet në fushën e IT.

2. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. gjatë kohës së përgatitjes së dokumentacionit për procedurat e prokurimit nuk ka shënuar numrin e protokollit, datën e realizimit për shumë nga dokumentet e paraqitura.

Situata: Për katër nga pesë kontratat e mësipërme mungon numri i protokollit si dhe në shumë raste gjatë dokumentimit të procedurave mungon gjithashtu dhe data e realizimit të dokumentacionit gjë e cila nuk jep siguri të arsyeshme gjatë punës audituese për vërtetësinë e dokumenteve.

Ndikimi/Efekti: Mos shënimi i numrit të protokollit si dhe datës së realizimit sjell hije dyshimi mbi vërtetësinë e dokumentacionit.

Shkak: Neglizhenca e personave përgjegjës pjesëmarrës në procedurë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

Për të gjithë dokumentacionin mbështetës të procedurave të prokurimit të shënohen numrat e protokollit dhe data e realizimit si dhe çdo plotësim i nevojshëm sipas dokumenteve standarde.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

2.c. Auditimi i zhvillimi dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

2.c. Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH)

Objektivat e auditimit:

- Vlerësimi nëse agjencia ka zhvilluar një marrëveshje të detajuar në nivel shërbimi së bashku me të gjitha kërkesat dhe nëse është aktivisht monitoruese ndaj shoqërisë ofruese.
- Vlerësimi nëse kërkesat e sigurisë janë adresuar në prokurim dhe janë në përputhje me to.

Për gjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2019, periudhë mbi të cilën Ujësjetllës-Kanalizime Fier sh.a. (UKF) është nën auditim, ka kryer identifikimin, planifikimin dhe pajisjen me mallra dhe shërbime në fushën e IT, nga drejtoritë përkatëse.

Gjatë hartimit të Planit Ekonomik të Ujësjetllës-Kanalizime Fier Sh.A. (UKF), personat përgjegjës të hartimit të këtij plani kanë marrë për bazë këto nevoja dhe kanë bërë të mundur priorizimin e tyre duke marrë parasysh dhe të ardhurat.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmblendhur Prokurimet me bazë MNSH-je (duke përfshirë dhe 2 prokurime me vlerë të vogël) që mbulojnë fushën e IT për vitin 2019.

Lista e objekteve të prokuruarra për IT

Nr	Objekti i procedurës Emertimi	Lloji i prokurimit	Fondi limit (Pa tvsh) Në lek	Operatori fitues	Nr.prot. Data e kontratës	Vlera e ofertave të paraqitura nga fituesi (Pa tvsh) Në lek	Diferenca nga fondi limit (Pa tvsh)	Vlera e kontratës (me tvsh)
a	1		3	4	5	6	7	8
1	Shërbim mirëmbajtje AL-Billing	Me negociim, pa njoftim	770.000	xxx Sh.p.k	23.05.2018	760.000	10.000	912.000
2	Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF	Kërkesë për propozim	1.999.308	xxx	25.07.2019	1.174.080	825.920	1.408.824
3	Shërbime Printerash, Fotokopje dhe Kompjuterash	Blerje me vlerë të vogël	390.000	xxx	19.03.2019	390.000	10.000	468.000
4	Shërbim Printim Faturash	Kërkesë për propozim	3.000.000	xxx	16.04.2019	2.644.800	355.200	3.173.760
5	Blerje bojra për printera	Blerje me vlerë të vogël	295.000	xxx	01.02.2019	59.000	236.000	70.800
	Total		6.454.308			5.027.880	1.437.120	6.033.384

Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH).

Ujësjetllës-Kanalizime Fier Sh.a. për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 ka aktive të lidhura 3 kontrata të **Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit**:

- a) Kontrata më datë 23.05.2018 me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k
- b) Kontrata më datë 25.07.2019 me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k.
- c) Kontrata më datë 16.04.2019, me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

Gjetjet nga Auditimi:

1. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. gjatë hartimit të kontratave të prokurimeve në fushën e teknologjisë dhe informacionit, nuk kanë bërë të mundur bashkëngjitjen e kontratës së Marrëveshjes në Nivel Shërbimi si aneks i kontratës administrative.

Situata: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) respektivisht kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k., nuk ka të bashkëngjitur kontratën e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) si një aneks i kontratës administrative, të lidhur ndërmjet palëve në kundërshtim me pikën nr.6 të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Ndikimi/Efekti: Mos bashkëngjitja e kontratës së Marrëveshjes në Nivel Shërbimi sjell pasoja të mëdha në mosfunksionimin siç duhet të këtyre kontratave dhe deri në mos garantimin e vazhdimit të shërbimeve të ofruara nga operatorët ofrues.

Shkak: Neglizhenca dhe moskoordinimi me ligjet, VKM-të dhe udhëzimet përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:- Për të gjitha procedurat e prokurimit me bazë Marrëveshjen në Nivel Shërbimi (MNSH), të marrë masa që kontratave administrative të prokurimeve me bazë teknologjinë e informacionit, t’ju bashkëngjisë si aneks kontratën e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi MNSH-në, pra të hartojë dhe zbatojë Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

2. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. gjatë kohës që ka përfutuar shërbimin nuk ka zhvilluar ndonjë analizë për të përcaktuar cilësinë e shërbimit të marrë, mbi mënyrën e përdorimit të këtij shërbimi dhe gjithashtu mbi vlefshmërinë e këtij shërbimi.

Situata: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k., ka mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (Kolaudimin) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti, shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim (matja e cilësisë së shërbimit) sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (ç) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Ndikimi/Efekti: Mos analizimi i këtyre shërbimeve sjell që këto shërbime të mos jenë efektive dhe të ndodhin incidente të papritura.

Shkak: Mosnjohja me ligjin përkatës dhe inekzistenca e një strukture në institucion që të kujdeset për këto shërbime.

Rekomandim: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një grupi pune që të bëjë të mundur shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

3. Titulli i gjetjes: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A. gjatë kohës që ka lidhur kontratat nuk ka vendosur një person ose një grup personash bashkë me informacionin e komunikimit me ato në mënyrë që të jenë në kontakt për të garantuar mbarëvajtjen dhe për të eliminuar incidentet e mundshme që mund të ndodhin.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave IT, nuk janë përcaktuar personat përgjegjës ose personat e kontaktit për AK dhe OE, mbi marrjen në dorëzim të projekteve IT, me qëllim ndjekjen dhe mbarëvajtjen e shërbimit të kërkuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (dh) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”

Ndikimi/Efekti: Risku që të ndodhin incidente është i lartë dhe zgjidhja e këtyre incidenteve në kohë është e vështirë.

Shkaku: Mosnjohja me ligjin përkatës dhe neglizhenca e krijuar nga personat përgjegjës.

Rekomandim: Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa për përcaktimin e hallkave përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

4. Titulli i gjetjes: Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a. gjatë kohës që ka hartuar kontratat e prokurimeve, nuk ka marrë parasysh kohëzgjatjen e kontratës..

Situata: Nga auditimi i kontratës me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., u konstatua se kohëzgjatja e kësaj MNSH-je nuk është hartuar në përputhje të plotë me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” pika 2, paragrafi b

Ndikimi/Efekti: Risku që institucioni të mbetet pa shërbim dhe zgjidhja e këtyre incidenteve mund të ndodhi në një kohë relativisht të gjatë.

Shkaku: Mosnjohja me ligjin përkatës.

Rekomandim: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e elementëve të nevojshëm në përputhje me kërkesat mbi zbatimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.a Auditimi i Sigurisë së Informacionit.

3.a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e tyre.

Objektivi i auditimit: Verifikimi se të gjithë risqet e lidhur me sigurinë e informacionit janë identifikuar dhe se ekziston një strategji e përshtatshme për reduktimin e riskut.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Auditimi mbi Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, dt. 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, risqeve të identifikuar dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave.

Gjetje nga Auditimi :

1. **Titulli i gjetjes** Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike

Situata: Nga auditimi i konstatua se Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a kryen backup-in e bazës së të dhënave në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*dhoma e serverëve*).

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e procesit të backup-in sipas standardeve më të mira mbi ruajtjen e të dhënave.

2. **Titulli i gjetjes** Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve, aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF..

3. **Titulli i gjetjes** Siguria e infrastrukturës network në Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, paisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- Firewall Hardware
- Switch të menaxhueshëm

Situata: Infrastrukturë pa nivel sigurie.

Ndikimi/efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mungesë e investimeve

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrë masat e nevojshme me qëllim rritjen e sigurisë në infrastrukturën network duke analizuar, prioritarizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat e institucionit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime FIER SH. A.

3.b. Auditimi i Sigurisë së Informacionit.

3.b. Të drejtat e përdoruesit dhe menaxhimi i tyre

Informacion i Përgjithshëm

UKF (Ujësjiellës Kanalizime Fier) për arritjen e objektivave dhe efikasitetin e punës përdorë tre programe kompjuterik kryesorë të cilët janë : Al-Billing, Web-Gis, Alpha-Web.

- Web-Gis është një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale në të cilin paraqitet e gjithë harta e kanalizimeve ,me anë të tools-ave kjo hartë mund të krijohet,fshihet dhe modifikohet nga punonjësit që kanë akses. Ky sistem nuk është në përdorim.
- Alpha-Web është program kompjuterik për administrimin dhe kontrollin e plotë të një ndërmarrje dhe degëve të saj të ndodhura në largësi, kontrollon ecurinë e ndërmarrjes nëpërmjet raporteve lehtëson punën e regjistrimit dhe përpunimit të dokumenteve të shitjes, blerjes, arkës, bankës, magazinës, doganës, pagave.
- Nëpërmjet AL-Billing administrohet sistemi, informacioni i abonentëve si dhe specifikave të tyre, administrohet procesi i faturimit, tarifimit, procesi i arkëtimit, procesi i kërkesë/ankesave.

Për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019 përdorues aktivë të Sh.A UKF-së janë 83

Është vendimtare mënyra se si autorizimi nga zotëruesit i të dhënave (Administratori) përcillet tek përdoruesit, të cilët duhet të informohen mbi përgjegjësitë e tyre në mbrojtjen e informacionit sensitiv dhe të aseteve, nëse i'u është dhënë akses i përkates dhe akses i informacionit në nivel me përgjegjësinë e punës.

Nga Auditimi u konstatua se:

1.1 Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se dhënia dhe ndalimi i aksesit të informacionit për përdoruesit e sistemeve (punonjës të brendshëm, të jashtëm, të larguar nga puna apo punonjës të transferuar) nuk shoqërohet me një dokumentacion për të dokumentuar dhe administruar këta përdorues. Krijimi dhe fshirja e përdoruesve bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

1.2 Titulli i gjetjes: UKF Sh.a nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përputhje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtuar mbi arkitekturën “multirole dhe multiuser” duke ofruar mundësinë e krijimit apo aksesit të informacionit në sisteme.

Situata: UKF regjistrimin, fshirjen e llogarive, ndarjen e roleve në program të punonjësve të saj e kryen verbalisht duke mos vërtetuar nëse puna është kryer e saktë dhe në kohën e duhur.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave, mos aksesim i duhur në informacion.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: UKF të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve, ndarjen e duhur të roleve në sisteme për aksesin në informacion, në mënyrë që të dokumentohet gjurma e auditimit.

2. Titulli i gjetjes: Ndërrimi i fjalëkalimeve nuk kryhet në afate kohore të caktuara



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

Situata: Nuk kryhen ndryshime sistematike të fjalëkalimeve (minimalisht 60 ditë), e përcaktuar dhe në manualin e përdorimit të programit Al-Billing, në mënyrë që ruajtja e të dhënave të jetë më e sigurt duke ulur mundësinë e hyrjeve të paautorizuara në të dhënat e sistemit.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje e të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave të mira.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: UKF të marrë masa për përmirësimin në mënyrë sistematike të procesit të vendosjes së fjalëkalimeve me qëllim rritjen e sigurisë së aksesit.

3. Titulli i gjetjes: Deklaratat e konfidencialitetit të gjithë punonjësve kanë të njëjtën datë nënshkrimi..

Situata: Nga auditimi u konstatua se deklarata e konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv, nuk përkon me datën e fillimit të punës së punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese në UKF të marrin masa për monitorimin e dhënies së aksesit në sistemet e UKF, vetëm të punonjësve të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, mbi informacionet sensitive.

4. Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit

4.a. Verifikim i kontrolleve të Aplikacioneve për të dhënat Input /Output

Objektivat e auditimit:

- A është i përshtatshëm menaxhimi i dokumenteve burimorë dhe i mbledhjes së të dhënave?
- A përmban aplikacioni “Al Billing” procedura të përshtatshme për trajtimin e gabimeve?
- Si menaxhohet autorizimi i futjes së të dhënave në aplikacion?
- Vlerësimi nëse informacioni i aplikacionit “Al Billing” është i sigurt kundrejt keqpërdorimeve.

Informacion i Përgjithshëm

UKF SH.A përdor për faturim Sistemin e Faturimit “Al Billing” prodhim i kompanisë “Jehona shpk”. Me kontratë qeraje që prej vitit 2012.

Nëpërmjet këtij sistemi faturimi administrohet:

- Informacioni i abonentëve,
- Procesi i faturimit, tarifimit,
- Procesi i arkëtimit,
- Procesi i kërkesë/ankesave,
- Administrohet posta elektronike,
- Të tjera.

UKF SH.A nëpërmjet sistemit “Al Billing” për vitin 2019 ka krijuar 1.437.687 rekorde për 37299 Abonentë në ujësjellës kanalizime.




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

+

Muaji	Rekorde
Janar	131.207
Shkrut	95.137
Mars	111.860
Prill	137.746
Maj	179.483
Qershor	45.518
Korrik	136.835
Gusht	119.622
Shtator	105.864
Tetor	111.975
Nëntor	97.102
Dhjetor	165.338
Total	1.437.687



Nga auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A ka printuar fatura tatimore të pa miratuara (për periudhën nën auditim 01.01.2019-31.12.2019).

Situata: Nga auditimi u konstatua se UKF SH.A nuk ka kryer (për periudhën nën auditim 01.01.2019-31.12.2019) procedurat për miratimin e faturës tatimore duke lejuar gjenerimin nga sistemi “Al Billing” të faturave me TVSH pa kod fiskal.

Ndikimi/efekti: Mos realizimin e objektivave institucionale.

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për miratimin e faturave tatimore të gjeruara nga sistemi “Al Billing”.

2. Titulli i gjetjes: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A në Sistemin e Faturimit “Al Billing”, kanë kryer sistemime dhe janë gjeneruar ID dublikata dhe jo ID të reja. Për këtë proces pune nuk është mbajtur asnjë dokumentacion argumentues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në sistemin e faturimit “Al Billing” janë kryer veprime për sisteme duke gjeneruar 53 dublikata në fushën “Numri Serial” për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

Ndikimi/efekti: mbivendosje të dhënash.

Shkaku: Mos zbatim të rregullave në administrimin e programeve që administrojnë vlera monetare Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për të mos krijuar dublikate. UKF SH.A. duhet të dokumentojë çdo proces pune mbi ndryshimet dhe sistemet në sisteme.

3. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A në Sistemin e Faturimit “Al Billing”, kanë kryer sisteme dhe janë gjeneruar ID me Hendeqe.

Situata: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “Al Billing” për periudhën 01 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 94,970,256 “Hendeqe” në fushën ID. Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkriminale, si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s’ të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.

Ndikimi/efekti: Hendeqe ndërmjet të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim të rregullave në administrimin e programeve që administrojnë vlera monetare Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për analizimin e situatës së krijuar në lidhje me “Hendeqet” në fushën ID, duke e vendosur atë si fushë automatike dhe inkrementale, me qëllim krijimin e sigurisë së arsyeshme të+ gjurmës së auditimit të të dhënave të sistemit “Al-Billing”.

4. Titulli i gjetjes: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka hartuar bazën rregullative të Sistemit të Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar në të përmbahen logo e përshkrime të institucioneve që nuk kanë lidhje me UKF Sh.A

Situata: Nga auditimi u konstatua se UKF Sh.a nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operacionale në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar.

Ndikimi/efekti: Baza nënligjore e pa hartuar mbart riskun e mos realizimit të objektivave

Shkaku: Mos zbatim i praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullatore të Sistemit të Faturimit “Al Billing” dhe përditësimin e manualit të përdorimit të sistemit.

5.a. Të tjera.

5.a. Auditimi i sistemeve të matjes dhe faturimit

Menaxhimi i aseteve nga UKF nëpërmjet programit WebGis



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime FIER SH. A.

Informacion i përgjithshëm

Për menaxhimin e aseteve në UKF Sh.A është implementuar Programi “Web-GIS, i cili është një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale ndërtuar mbi arkitekturën multrole dhe multuser.

Në këtë sistem regjistrohen:

1. Ankesat	11. Burim vetërrjedhje	21. Kanalizim i Hapur
2. Zonë faturimi	12. Pus	22. Pusetë-Kanalizime
3. Pus familjar	13. Stacion pompimi	23. Gradele
4. Lidhje uji	14. Depo Uji	24. Pikë derdhje
5. Klient	15. Impiant Pastrimi	25. Impiant trajtmi
6. Bashkues	16. Nyje	26. Stacion pompimi-
7. Linjë	17. Zonë hidraulike	27. Ndërtese
8. Pusetë	18. Bashkues mbi linjë	28. Rrugë
9. Hidrant	19. Ndaj linjë	
10. Ujëmatës zonal	20. Kanalizim nën tokë	

Sistemi ka të realizuar një sërë rolesh të cilat kanë mundësi krijimi apo aksesit të informacionit në aplikacion. Rolet(Grupet) janë si më poshtë:

- Administratori :

Ka mundësinë e menaxhimit të log-eve të sistemit. Sistemi mundëson monitorimin e çdo veprimi të kryer mbi të, në formën e log-eve. Loge-t mund të aksesohen dhe prej tyre të nxirren monitorime të ndryshme, duke filtruar sipas përdoruesit, datës dhe veprimet mbi sistemin.

- Punonjës i Ujësjiellësit (ujë_punonjës)

Punonjësi i Ujësjiellësit ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetën e ujësjiellësit. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose dakordësi të përdoruesit që ka hedhur të dhënat. Ky përdorues ka gjithashtu të drejtë të lexojë por jo të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga sektori i kanalizimeve. ujësjiellësit.

- Punonjës i Kanalizimeve

Punonjësi i Kanalizimeve ka të drejtë të shtojë dhe të ndryshojë të gjitha objektet që kanë lidhje me rrjetën e kanalizimeve. Të gjitha të dhënat e hedhur prej tij nuk mund të ndryshohen nga asnjë përdorues tjetër përveç administratorit të sistemit të shoqëruar me një urdhër ose të modifikojë të gjithë objektet që hidhen dhe mirëmbahen nga përdorueset e rrjetit të ujësjiellësit.

- Vizitor

Vizitor është një përdorues i sistemit i cili ka të drejtë të lexojë çdo informacion që hidhet si për rrjetin e ujësjiellësit ashtu dhe atë të kanalizimeve. Ai nuk ka të drejtë hedhje apo ndryshimi të dhënash në asnjë nga objektet e sistemit.

Për UKF një menaxhim i mirë i Web Gis do sjellë rritjen e nivelit shërbimit për komunitetin përmes krijimit, përvetësimit, operimit, mirëmbajtjes së aseteve të Sh.a.

Me përdorimin e WebGis UKF mund të përcaktojë vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të inventarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin(vendin) e objektit.

Objektivi i auditimit: Verifikimi i përdorimit të Aplikacionit WebGis me qëllim që të dhënat të regjistrohen , programi të popullohet në mënyrë që të gjitha asetet e Ujësjellës Kanalizime Fier të ruhen në një sistem menaxhimi asetesh gjeospaciale, për të rritur efektivitetin dhe eficientë.

Nga Auditimi u konstatua se:

1. Titulli gjetjes Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve Web-Gis në UKF Sh. A. është ndërtuar mbi një arkitekturën multrole dhe multuser. Sistemi i ngritur dhe ai i koordinatave mund të bëhen mjete me shumë vlerë për analizimin e funksionimit të rrjetit. Sistemi përfshin vendndodhjen e aseteve së bashku me të dhënat e tjera të inventarit, dhe mundëson përpunime të ndryshme duke i bashkëlidhur asetit edhe emrin e rrugës, adresën, ose pozicionin(vendin) e objektit. Nuk mund të gjenerojë raporte të plota për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxherët, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët). UKF Sh. A. nuk ka përfunduar regjistrimin e aseteve në programin Web Gis. Ky sistem nuk përcakton vendndodhjen e aseteve duke përdorur rrjetin e koordinatave të marra nga sistemi

Situata: Nga auditimi u konstatua se popullimi i programit “Web-GIS, i kontraktuar me qëllim menaxhimit të aseteve, është në nivel të ulët, duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të të gjithë pjesëve përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKF. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar. Duke qenë se popullimi i aseteve nuk është bërë, programi nuk mund të gjenerojë raporte, për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxheret, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët).

Ndikimi/efekti: Mos përdorim dhe menaxhim me eficient, ekonomikiteti dhe efektivitet të aseteve të UKF Sh. A.

Shkaku: Mungesa në menaxhim nga Stafi i lartë drejtues në implementim dhe shfrytëzim të Web-Gis në UKF Sh. A.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKF Sh. A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në eficientë të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit

5.b Të tjera

5.b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike

Objektivi i auditimit: Parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ambienti fizik i dhomave të serverëve.

Dhoma e serverave është vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit, sinjalizimit dhe pajisje të tjera



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

elektronike. Dhoma e serverave është pika me sensibël e një sistemi informatikë dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Ambientet e dhomës së serverave të Ujësjellës Kanalizime Fier



- *Fotografia 1 dhe 2: Paraqesin dy Rack-e me struktura fizike metalike dhe pjesët përbërëse të sistemit të pajisjeve elektronike dhe elektrike: server, switch, router, UPS, panele etj*
- *Fotografia 3: Paraqet sistemin e ftohjes së dhomës së serverave.(Pajisje konditioner)*

Nga Auditimi u konstatua se:

1. Titulli i gjetjes Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

2. Situata: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d.Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f.Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

Ndikimi/efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A. të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A. ka dërguar Projekt Raportin e Auditimit të nënshkruar nga Drejtori i Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh. A., me shkresë përcjellëse nr. 309 prot, datë 15.05.2020.

Bashkëlidhur Projekt Raportit janë paraqitur observacione të cilat janë marrë pjesërisht në konsideratë dhe janë reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Saktësisht:

U mor në konsideratë observacioni për gjetjen nr 3 (fq 14) të Projekt Raportit dhe u reflektua në Raportin përfundimtar.

Nuk u mor në konsideratë observacioni i bërë mbi gjetjen nr. 2 (fq 14) të projekt Raportit mbi mungesën e numrave të protokollit. Grupi i auditimit zotëron fotokopje të vëna në dispozicion nga ju, kontrata pa nr. protokollit.

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr.9-10. të Raportit të Auditimit.)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A., duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka politika mbi sigurinë dhe Vazhdueshmërisë së Punës së Institucionit. Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A dhe nuk ka krijuar kushtet e nevojshme për vënien në dispozicion rregulloreve të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit me qëllim që të gjithë punonjësit të familjarizohen dhe ta bëjnë pjesë të mënyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr.10-11 të Raportit të Auditimit.)

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A., të marrin masa për hartimin e dokumenteve të nevojshme për mirëfunksionimin dhe vazhdimësinë e punës pa ndërprerje në institucion si dhe njohjen me rregulloret dhe politikat TIK ekzistuese të të gjithë punonjësve përgjegjës mbi sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetellës Kanalizime FIER SH. A.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Struktura IT nuk ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e backup, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve në sistem etj).

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 11 të Raportit të Auditimit.)

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve t, dokumentacion mbi procedurat e backup etj).

Brenda vitit 2020

4. Gjetje nga Auditimi: Nuk ka plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Nga ana e burimeve njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 11 të Raportit të Auditimit.)

4.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Organizimi i strukturës IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A duke zbehur ndikimin e varësisë direkt nga menaxhimi i lartë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr.11 të Raportit të Auditimit.)

5.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A të analizojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore të strukturës ekzistuese IT me qëllim rritjen e rolit të saj.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A ka regjistër risku për teknologjinë e informacionit të pa miratuar dhe në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik

6.1. Gjetje nga Auditimi: Ujësjetellës Kanalizime Fier Sh.A nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

6.2. Gjetje nga Auditimi: Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 12 të Raportit të Auditimit.)

6.3. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.A të marrin masa për hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave për:

- a) identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrimit të risqeve.
- b) dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- c) menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
- d) miratimin e regjistrimit të riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procesit të identifikimit të nevojave për investime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe priorizimit të tyre konstatohet se Struktura e IT-së nuk është përfshirë në procesin e identifikimit të nevojave si dhe nuk përfshihet në procesin e menaxhimit të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 13-14 të Raportit të Auditimit.)

7.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a. të rishikojë pozicionimin e strukturës IT afër qeverisjes me qëllim kryerjen e analizimit, prioritarizimit dhe planifikimit të nevojave për sistemet e reja dhe ekzistuese të Teknologjisë së Informacionit në të ardhmen si dhe të marri masa për rritjen e bashkëveprimit ndër-institucional në përputhje me politikat dhe strategjitë për parashikimin dhe koordinimin e investimit në fushën e IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Për katër nga pesë kontratat e mësipërme mungon numri i protokollit si dhe në shumë raste gjatë dokumentimit të procedurave mungon gjithashtu dhe data e realizimit të dokumentacionit gjë e cila nuk jep siguri të arsyeshme gjatë punës audituese për vërtetësinë e dokumenteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 14 të Raportit të Auditimit.)

8.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen: Për të gjithë dokumentacionin mbështetës të procedurave të prokurimit të shënohen numrat e protokollit dhe data e realizimit si dhe çdo plotësim i nevojshëm sipas dokumenteve standarde.

Në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i tre kontratave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) respektivisht kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN për Nevojat e Sh.a UKF” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k., nuk ka të bashkangjitur kontratën e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) si një aneks i kontratës administrative, të lidhur ndërmjet palëve në kundërshtim me pikën nr.6 të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 14-16 të Raportit të Auditimit.)

9.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:- Për të gjitha procedurat e prokurimit me bazë Marrëveshjen në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime FIER SH. A.

Nivel Shërbimi (MNSH), të marrë masa që kontratatave administrative të prokurimeve me bazë teknologjinë e informacionit, t'ju bashkëngjisë si aneks kontratën e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi MNSH-në, pra të hartojë dhe zbatojë Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i tre kontratatave të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (MNSH) kontratën me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., kontratën me objekt “Shërbim Interneti LAN TO LAN per Nevojat e Sh.a UKF” me fitues operatorin ekonomik “xxx” sh.p.k. dhe kontratën me objekt “Shërbim Printim Faturash” me fitues Operatorin Ekonomik “xxx” sh.p.k, ka mangësi në procesin e vlerësimit të shërbimit (Kolaudimin) kur dihet që përfundimi i implementimit të çdo projekti, shoqërohet me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim (matja e cilësisë së shërbimit) sipas udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (ç) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 16-17 të Raportit të Auditimit.)

10.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa përkatëse për ngritjen e një grupi pune që të bëjë të mundur shoqërimin me kolaudime të pjesshme ose me një analizë kosto-përfitim të shërbimeve të përfituara për të bërë një vlerësim efikas mbi cilësinë dhe garantimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve.

Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratatave IT, nuk janë përcaktuar personat përgjegjës ose **personat e kontaktit** për AK dhe OE, mbi marrjen në dorëzim të projekteve IT, me qëllim ndjekjen dhe mbarëvajtjen e shërbimit të kërkuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për et TIK në Administratën Publike” pjesa III pika 10 Aneksi 2 dhe sipas pikës 8 (dh) të Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.. (Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 17 të Raportit të Auditimit.)

11.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit, të marrë masa për përcaktimin e hallkave përkatëse të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve duke dokumentuar procesin monitorues.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kontratës me objekt “Shërbim mirëmbajtje AL-Billing” me fitues operatorin ekonomik “xxx” Sh.p.k., u konstatua se kohëzgjatja e kësaj MNSH-je nuk është hartuar në përputhje të plotë me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” pika 2, paragrafi b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 17 të Raportit të Auditimit.)

12.1. Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Fier Sh.a. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor të ketë parasysh në të ardhmen:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjiellës Kanalizime FIER SH. A.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit në teknologjinë e informacionit të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e elementëve të nevojshëm në përputhje me kërkesat mbi zbatimin e Marrëveshjeve e Nivelit të Shërbimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i konstatua se Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.a kryen backup-in e bazës së të dhënave në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*dhoma e serverëve*).

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 17-18 të Raportit të Auditimit.)

13.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e procesit të backup-in sipas standardeve më të mira mbi ruajtjen e të dhënave.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.a nuk ka kryer analizë risku lidhur me Sigurinë e të dhënave, identifikimin e të dhënave kritike si dhe kërcënimet e mundshme në ndikim të sistemeve, aplikacioneve ku zhvillohet aktiviteti i UKF.

14.1. Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës network në Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet;
- Firewall Hardware;
- Switch të menaxhueshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 18 të Raportit të Auditimit.)

14.2. Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.a të marrë masat e nevojshme me qëllim rritjen e sigurisë në infrastrukturën network duke analizuar, prioritarizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat e institucionit.

Në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se dhënia dhe ndalimi i aksesit të informacionit për përdoruesit e sistemeve (punonjës të brendshëm, të jashtëm, të larguar nga puna apo punonjës të transferuar) nuk shoqërohet me një dokumentacion për të dokumentuar dhe administruar këta përdorues. Krijimi dhe fshirja e përdoruesve bëhet verbalisht nga administruesit e programeve përkatës.

15.1. Gjetje nga Auditimi: UKF Sh.a nuk ka procedura për të përcaktuar akseset dhe privilegjet e përdoruesve në mënyrë që përdorimi i informacionit të jetë në përputhje me nivelin dhe pozicionin e punës, duke qenë se programet janë ndërtuar mbi arkitekturën “multirole dhe multiuser” duke ofruar mundësinë e krijimit apo aksesit të informacionit në sisteme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 18-21 të Raportit të Auditimit.)

15.2. Rekomandimi: UKF të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave për krijimin dhe fshirjen e përdoruesve, ndarjen e duhur të roleve në sisteme për aksesin në informacion, në mënyrë që të dokumentohet gjurma e auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

16. Gjetje nga Auditimi: Nuk kryhen ndryshime sistematike të fjalëkalimeve (*minimalisht 60 ditë*), e përcaktuar dhe në manualin e përdorimit të programit Al-Billing, në mënyrë që ruajtja e të dhënave të jetë më e sigurt duke ulur mundësinë e hyrjeve të paautorizuara në të dhënat e sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr.21-22 të Raportit të Auditimit.)

16.1. Rekomandimi: UKF të marrë masa për përmirësimin në mënyrë sistematike të procesit të vendosjes së fjalëkalimeve me qëllim rritjen e sigurisë së aksesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se deklarata e konfidencialitetit për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e informacionit sensitiv, nuk përkon me datën e fillimit të punës së punonjësve që kanë akses në të dhënat e sistemeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 22 të Raportit të Auditimit.)

17.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në UKF të marrin masa për monitorimin e dhënies së aksesit në sistemet e UKF, vetëm të punonjësve të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, mbi informacionet sensitive.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKF SH.A nuk ka kryer (për periudhën nën auditim 01.01.2019-31.12.2019) procedurat për miratimin e faturës tatimore duke lejuar gjenerimin nga sistemi “Al Billing” të faturave me TVSH pa kod fiskal.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 22-25 të Raportit të Auditimit.)

18.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për miratimin e faturave tatimore të gjeneruara nga sistemi “Al Billing”.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin e faturimit “Al Billing” janë kryer veprime për sistemime duke gjeneruar 53 dublikata në fushën “Numri Serial” për të cilat nuk mbahet dokumentacion për argumentimin e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 25 të Raportit të Auditimit.)

19.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për të mos krijuar dublikate. UKF SH.A. duhet të dokumentojë çdo proces pune mbi ndryshimet dhe sistemimet në sisteme.

Në vijimësi

20. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i bazës së të dhënave të Sistemit të Faturimit “Al Billing” për periudhën 01 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 94,970,256 “Hendeqe” në fushën ID. Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkriminale, si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s’të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqen nr. 25 të Raportit të Auditimit.)

20.1. Rekomandimi Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për analizimin e situatës së krijuar në lidhje me “Hendeqet” në fushën ID, duke e vendosur atë si fushë automatike dhe inkrementale, me qëllim krijimin e sigurisë së arsyeshme të+ gjurmës së auditimit të të dhënave të sistemit “Al-Billing”.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në Ujësjellës Kanalizime FIER SH. A.

21. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se UKF Sh.a nuk ka hartuar rregullore apo udhëzime mbi veprimet operationale në Sistemin e Faturimit “Al Billing” për parametrizime të ndryshme të sistemit apo dhe hapat që duhen ndjekur në rastin e anulimit/ndryshimit të rekordeve në bazën e të dhënave. Manuali i Sistemin e Faturimit “Al Billing” është i pa përditësuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr.25- 26 të Raportit të Auditimit.)

21.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a të marrin masa për hartimin dhe miratimin e bazës rregullatore të Sistemit të Faturimit “Al Billing” dhe përditësimin e manualit të përdorimit të sistemit.

Brenda vitit 2020

22. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se popullimi i programit “Web-GIS, i kontraktuar me qëllim menaxhimin e aseteve, është në nivel të ulët, duke mos përfunduar identifikimin, pasqyrimin e aseteve të të gjithë pjesëve përbërëse të rrjetit të akumulimit dhe të shpërndarjes së ujit në UKF. Të dhënat rreth stacioneve të pompimit, linjave, puseve, depove nuk janë regjistruar. Duke qenë se popullimi i aseteve nuk është bërë, programi nuk mund të gjenerojë raporte, për vendndodhjen e këtyre aseteve për menaxheret, punonjësit e ujësjellësit, ashtu dhe për vizitorët (qytetarët).

(Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 26-28 të Raportit të Auditimit.)

22.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të UKF Sh. A. të marrin masa për analizimin e gjendjes dhe hartimin e një plan veprimi për vënien në efikasitet të programit Web-Gis, të kryhet regjistrimi sistematik i aseteve dhe rezultatet të jenë të aksesueshme në përputhje me qëllimin e sistemit.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

23. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI përkatësisht:

a.Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

b.Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

c.Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës. (Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqet nr. 28-29 të Raportit të Auditimit.)

23.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Fier Sh. A. të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit ushtruar në
Ujësjetës Kanalizime FIER SH. A.**

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

Me ndjekjen e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë raport auditimi ngarkohet Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT